



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

08.11.2019

02-035/02-1123

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L-040 Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr 28/2008 dhe nenit 51, paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Vitisë nr 01-013/491 të datës 21.04.2011, dhe nenit 19.2 të Rregullores për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për varreza, mirëmbajtjen e tyre dhe shërbimet e varrimit në territorin e Komunës së Vitisë nr 01-013/1962 të datës 30.12.2014, Kryetari i Komunës së Vitisë bien këtë:

#### V E N D I M

### PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE NË SHUMË PREJ 5,590.00€ KËSHILLIT TË BASHKËSISË ISLAME NË VITI

#### Neni 1.

Kryetari i Komunës së Vitisë, ndan mjetet financiare në shumë prej 5,590.00€ (pesëmijë e pesëqind e nëntëdhjetë euro) Këshillit të Bashkësisë Islame në Viti në emër të shërbimeve të varrimit të persona të vdekur në Komunën e Vitisë prej 28.04.2019 deri më datë 27.07.2019. Mjetet nga neni 1 i këtij vendimi derdhen në llogari të Këshillit të Bashkësisë Islame në Viti në llogarinë 17-02-001600083743.

#### Neni 2.

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është regjistri i shërbimeve të varrimit i Këshillit të Bashkësisë Islame i qytetarëve të vdekur në Komunën e Vitisë prej 28.04.2019 deri më datë 27.07.2019 për 43 persona të vdekur (nga numri 01 deri 43 i faturës). Numri i faturës nr 198/19 të datës 02.09.2019. Mjetet nga neni 1 i këtij vendimi sigurohen nga buxheti i Komunës së Vitisë për vitin 2019 nga kodi buxhetor për subvencione i Zyres së Kryetarit të Komunës së Vitisë.

#### Neni 3.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim dhe Zyra e thesarit e Komunës së Vitisë.

#### Neni 4.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës së Vitisë.

KRYETARI I KOMUNËS SË VITISË

Viti: 08.11.2019

Sokol Haliti